



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA STUDIMI NË HUNGARI, VITI AKADEMIK 2015-2016

Qeveria e Republikës së Hungarisë përmes Zyrës së Bordit të Bursave Hungareze pranë Institucionit të Arsimit të Lartë "Balassi" shpall programin e bursave shtetërore për shtetasit e huaj të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet universitare, pasuniversitare, ose në fushën e kërkimit, si dhe në kurse vere pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë ose të Kërkimit të Hungarisë, për vitin akademik 2015-2016 sipas kategorive të ndara si më poshtë:

A- Studime të pjesshme në nivelin Bachelor dhe Master (3-10 muaj);

Për këto bursa mund të aplikojnë studentë për programe të ndryshme studimi në Bachelor (BA) ose Master Shkencor (BSc). Për llojin A preferohen ata kandidatë që studiojnë ose punojnë në fushën e gjuhës dhe të letërsisë hungareze, ose studentë të regjistruar në programet e studimit: mjekësi e përgjithshme, stomatologji, farmakologji, veterinar, arkitekturë dhe drejtësi. Kandidatët e interesuar duhet të kenë përfunduar të paktën 2 semestra në institucionet e arsimit të lartë të vendit të tyre. Moshë e rekomanduar është deri në 30 vjeç.

B - Studime pasuniversitare ose në fushën e kërkimit (3-21 ditë ose 1-10 muaj);

Për këtë kategori burse të gjithë të interesuarit duhet të jenë të pajisur me një diplomë të nivelit Master. Rekomandohen aplikantë, të cilët dëshirojnë të kryejnë kërkime për tezën e studimit në PhD. Por këta kandidatë duhet të jenë në vazhdim të studimeve në programin e doktoraturës. Aplikantët që përfshihen në këtë nivel studimi, nuk përfitojnë kredite. Moshë e rekomanduar është deri në 40 vjeç.

C/1: Studime në Doktoraturë (PHD,) program i plotë (36 muaj);

Bursa jepet me kusht për ata kandidatë që i nënshtrohen provimit para pranimit në universitet për programin PhD. Aplikantët nuk duhet të jenë më shumë se 35 vjeç .

C/2: Studime në Doktoraturë (PHD, program i pjesshëm 1-12 muaj;

Për këtë program mund të aplikojnë vetëm ata studentë që janë të regjistruar në doktoraturës në universitetet e akredituara të vendit të tyre, ose të një vendi tjetër të huaj, por jo në Hungari. Aplikantët nuk duhet të jenë më shumë se 35 vjeç.

D: Studime në postdoktoraturë dhe në fushën e kërkimit (1-10 muaj);

Aplikantët duhet të kenë titullin Doktor ose një gradë të barazvlefshme. Moshë e rekomanduar është deri më 45 vjeç.

E: Vizita Kërkimore (3-21 ditë, ose 1-10 muaj);

Aplikantët duhet të kenë minimalisht titullin "Doktor i Shkencave" ose një titull ekuivalent. Nuk ka kufizim moshe.

F: Kurse Vere (2-4 javë);

Nuk ka kufizim moshe. Lista e kurseve që mbulohen me bursë gjendet në faqen www.scholarship.hu

Kopje të dokumentacionit duhet të përcillen:

- Përmes aplikimit ONLINE të rrjetit HSB. Aplikantët duhet të bëjnë regjistrimin në website-in e Bordit Hungarez të Bursave (the HSB website). Gjatë procesit të aplikimit, ata duhet të shkarkojnë dokumentet përkatëse të përgatitura paraprakisht.
- Me postë. Dy kopje origjinale të dokumenteve dhe formulari i aplikimit (kopje e printuar) duhet të dërgohen njëkohësisht, krahas aplikimit online, në adresën e poshtëshënuar:

*Balassi Intézet, MÖB Iroda
(Balassi institute, HSB Office)
1519 Budapest Pf. 385
Hungary*

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve për këto bursa është **data 8 Prill 2015.**

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit referojuni materialeve informativë bashkëlidhur këtij njoftimi që gjenden në adresën:

www.scholarship.hu;
<http://www.scholarship.hu/Englishsite/Asemesterpartialstudies/tabid/186/language/en-US/Default.aspx>

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE